




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY
OF SHTIME

Zyra e kryetarit të Komunës/Kancelarija Predsednika Opstine/Mayor's Office

Data/Datum/Date:	05.05.2020
Nr.Br.No:	02/153
Për/ Za/To:	Kuvendin e Komunës, KPF, znj. Medina Brahaj - kryesuese
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës, z. Naim Ismajli 
Lënda/Predmet/Subject:	PROPOZIM - VENDIM

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2 dhe nenin 58 (pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), Ligji nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

PROPOZIM - VENDIM

PËR LIRIMIN NGA TAKSA KOMUNALE PËR PERSONA JURIDIK

Neni 1

Me këtë Propozim – Vendim, me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për shkak të pandemisë COVID – 19 që ka rezultuar me pezullim të shumë aktiviteteve, propozohet që të lirohen nga pagesa e obligimeve komunale për personat juridik si vijon:

1. Lirohen nga pagesa e qirasë bizneset në Zonën Ekonomike dhe pronat komunale tjera për shfrytëzimin e pronës komunale për vitin 2020;
2. Lirohen nga pagesa për Leje Qarkullimi, automjetet e rënda motorike në rrugët ku është ndaluar qarkullimi i automjeteve nga data e këtij Vendimi deri më 31 dhjetor 2020;
3. Lirohen nga pagesa për Taksa Komunale për shfrytëzimin e Pronës Komunale me destinacion të përkohshëm për vitin 2020;
4. Lirohen nga pagesa për Taksat për shfrytëzimin e hapsirave të tregut për vitin 2020.
5. Lirohen nga pagesa prindërit, fëmijët e të cilëve vijnë në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" Shtime në periudhën kohore nga pezullimi i aktiviteteve parashkollore deri në fillim e tyre.
6. Varësisht nga zhvillimet e situatës ky vendim mund të plotësohet dhe ndryshohet në kohë reale.